



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.390/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Faton Ademi, ne çështjen juridike te paditësit: nga te cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. nga , kundër te paditurës Komuna e Mitrovicës Drejtoria e Arsimit, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore, me dt.12.11.2018 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga Mitrovica dhe, **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës t'ia paguajë paditësit nga Mitrovica, ne emër te 3 pagave përcjellëse për në pension si punëtor teknik te e paditura për 7 vjet e 1 muaj te përvojës se punës shumën prej 769.50 € me kamat ligjore prej 8% nga dita e ngritjes se padis e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 259 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit te tij me datën 05.06.2018 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumën e përgjithshme prej 2.060.42 €.

Gjykata, me dt. 22.10.2018, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, si dhe përfaqësuesi i te paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë të shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbeten në tersi pran padis dhe kërkesëpadisë, ku në bazë të nenit 4 [ar 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës paditësi si punëtor teknik deri me rastrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka qenë i punësuar të e paditura, ku në bazë të qarkullimit bankar vërtetohet se paditësi që konform nenit 35 par 9 të kontratës ka realizuar pagë prej 256.50 €, kështu punësuarit i takojnë 3 paga përcjellës, ndërsa për shpërblim jubilar nuk ka të drejt sepse paditësi ka vetëm 7 vite përvojë pune, shpenzimet e procedurës i kërkoj.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë të shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj padinë jo për nga baza mirëpo nga aksepti material sepse e paditura nuk mund të përballojë pagesën e këtyre pagave sepse nuk ka buxhet të veçantë për këtë kategori, kjo është arsyeja e kundërshtimit të padisë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vendimi i dt.10.04.2018, Kontrata e punës e dt.28.10.2015, shkresa e dt.01.01.2018, vërtetimi i dt.29.05.2018, pasqyra e llogaris për periudhën 30.12.2017-31.01.2018, kopja e lejes së njoftimit të paditësit dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi para ngritjes së padis ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të dt. 03.04.2018 për kompensimin e pagave përcjellëse pas pensionimit, ndërsa e paditura me datë 01.06.2018 e ka njoftuar paditësin se sipas Ligjit të Punës nuk janë paraparë kompensime të tilla, ndërsa dispozitat e Kontratës Kolektive nuk janë obligative për punëdhënësin, kjo vërtetohet nga përgjigja në kërkesë e dt.01.06.2018.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura si punëtor teknik për më tepër se 7 vite, ky fakt u vërtetua nga vërtetimi i lëshuar nga Shkolla SHFMU " Bedri Gjina" me nr. të protokollit 53/2018 të dt.29.05.2018, si dhe nga kontrata e punës e dt.14.10.2015.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 256.50 € ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e datës 29.05.2018 për periudhën 31.01.2018 deri me 30.03.2018.

C
në
ng
për
përc
xje

APR
trovic
litësit
sion s
nën p
në p
vkimit

IGOH
simet e
a e mar.

irmes te e
in e te a
cjellëse i

dt. 22.10
ntuar i au

Nuk është kontestues se paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës për shkak të daljes në pension të pleqërisë me dt.01.04.2018, e kjo vërtetohet nga vendimi e dt.10.04.2018 lëshuar nga e paditura.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesë padisë, iu referua nenit 35 par. 9 n të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e cila parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës bankare të dt. 29.05.2018, se paditësi ka marrë tri pagat e fundit në vlerë prej 256.50 €

Prandaj, gjykata bazuar në nenit 35 par. 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej 769.50 €, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro në emër të përpilimit të padis dhe 20 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.390/2018 data 12.11.2018

GJYQTARI
Faton Ademi



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.